



RELACION TEKNIK

EMERTIMI I OBJEKTIT :

**“PUNIME PER NDERTIMIN,RIPARIMIN ,RRITJEN E SIGURISE SE DIGES DHE
PASTRIMIN E KANALIT TE SHKARKIMIT (VADITese)”**

**PROJEKTUES : SHOQERIA“HYDRO-ENG CONSULTING”Sh.p.k
Nr. Liçence ne projektim: N.7049/4**

POROSITES: BASHKIA BELSH

PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1.	TE PERGJITHSHME.....	2
1.1	Hyrje	2
1.2	Vendodhja dhe gjendja ekzistuese.....	2
1.3	Rilevimi Topografik	3
2.	ZGJIDHJA E PROJEKTIT	4
2.1	Organizimi i punimeve dhe specifikimi i materialeve	5
2.2	Konkluzionet	6

1. TE PERGJITHSHME

1.1 HYRJE

Në teritorin e Dumresë ka shumë liqene natyrorë që janë formuar si rezultat i fenomeneve karstike që kanë ndodhur dhe që vazhdojnë dhe sot në përmasa më të vogla. Sipërfaqja e tyre e përgjithshme është rreth 640 ha. Aftësia ujëmbajtëse 26 milion m³ ujë. Bukuritë e këtyre liqeneve kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj të cilët mund të shfrytëzohen edhe për turizëm. Këto liqene shfrytëzohen për peshkimin dhe vaditjen e kulturave bujqësore. Ata kanë madhësi dhe thellësi të ndryshme.

Sa me sipër, projekti i realizimit të Diges Shkendi, në fshatin shkendi, synon të identifikojë gjendjen, të propozojë ndërhyrjet teknike dhe të gjitha masat e nevojshme që lidhen me kryerjen e punimeve të përmirësimit të situatës së tanishme për sigurimin dhe garantimin e tokave bujqësore dhe vete fshatit Shkendi.

1.2 VENDODHJA DHE GJENDJA EKZISTUESE

Diga Shkendi është ndërtuar në liqenin Shkendi vite më parë me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore, banesave pranë saj sidomos gjatë rritjes së nivelit të ujit, duke u përdorur gjithashtu edhe për vaditjen e tokave bujqësore.

Në vitet e këtyre digës ka shfaqur probleme të qëndrueshme të skarpave.

Në fund të vitit 2022 këto probleme u bënë shumë shqetësuese. Pati rreshqitje të skarpave të bjeftit të poshtëm që fillonin në kuroren e digës. Megjithatë u bë ulja e nivelit të ujit në ujëmbledhës nëpërmjet krijimit të një kanali shkarkues, këto rreshqitje nuk u frenuan. Aktualisht skarpata e bjeftit të poshtëm të kësaj dige është pothuajse e gjitha me vatra rreshqitese dhe çarje përgjatë trupit të digës.

Mendojmë se shkak kryesor është mosfunksionimi i drenazheve të trupit të digës të cilat janë bllokuar totalisht gjatë viteve duke sjelle fryrje të liqenit gjatë periudhës së reshjeve.

Sa me sipër gjendja e kësaj ujëmbledhëse është shumë shqetësuese. Përveç mos funksionimit për qëllimin që është ndërtuar ai tashmë është rrezik i madh për banoret që janë nën trupin e digës, gjithashtu edhe për tokat bujqësore të cilat ulin prodhimtarinë duke qenë nën efektin e ujërave pothuajse gjatë gjithë pikut të reshjeve.



Pozicioni i Diges Shkendi



Foto e gjendjes ekzistuese



Foto e gjendjes ekzistuese

1.3 RILEVIMI TOPOGRAFIK

Per hartimin e Relievit te Diges Shkendi, ekipi i inxhinierëve topograf është angazhuar për kryerjen e matjeve topografike ne terren. Ne baze te ketyre matjeve është hartuar planimetria e gjendjes ekzistuese ne shkallen 1:1000, profilet gjatesor dhe terthor, qe do te jene baze per zgjidhjen e projektit.

2.0 ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Detyra e projektimit kërkon të hartohet projekti për: “Punime për Ndertimin, Riparimin ,Rritjen e Sigurise se Diges dhe Pastrimin e Kanalit te Shkarkimit (vaditese)”.

Projekti i zbatimit te hartohet sipas kushteve teknike te projektimit duke marre ne konsiderate te dhenat e mesiperme.

Projekti i zbatimit duhet te paraqese:

Planimetrine, profil gjatesor dhe profila terthore.

Relacionin teknik

Preventivin e punimeve

Specifikimet teknike

Çmimet e vleresimit do ti referohen manualit MRTT.

Projekti ka bere llogaritjet e nevojshme te volumeve te punimeve per zgjidhjen e paraqitur per te rritur sigurine per kete Ujembledhes.

Zgjidhja teknike parashikon ndertimin e nje shkarkuesi te ri me tuba betoni 1200 mm L=10ml,vazhdimi i shkarkimit me kanal betoni L=100 ml ,me qellim shkarkimi i ujit te ujembledhesit duke ruajtur nje kuote max te nivelit te ujit 1.0 m nga kurora e diges.

Gjithashtu bazuar ne situaten faktike te diges,ne skarpaten e bjefit te siperm dhe te poshtem do te nderhyet ne zonat e demtuara duke bere edhe nje ngritje te kurores se diges.


Keshtu ne bjefin e siperm do te realizohet mbushja me shtresa 20 cm ,do te vishet skarpata me nje shtrese zhavori dhe gure ndergohe ne biefin e poshtem do te germohet me shkallezime ,do te kryhet mbushja me shtresa cdo 20 cm dhe skarpata do te mbillet me bare.

Duke patur parasysh se, shkaqet qe kane çuar ne disa rreshqitje te skarpates se diges kane te bejne me natyren e dherave qe perfaqesojne trupin e diges , te cilat jane relativisht te ndjeshme ndaj ujrave siperfaqesore dhe deformohen shpejt njera mbi tjetren duke krijuar premisa per rreshqitje ne drejtim te renies se gradientit.Keto dhera me perberje te larta te fraksionit argjilor ne ne prezencen e ujit fryhen dhe humbasin gjendjen e ekuilibrit,pra ndodh shkarja.

Ne fundin e skarpates se jashteme dhe te brendshme te diges eshte parashikuar te ndertohet nje kontrabankine me mbushje me gure (sipas permasave detajuar ne projekt).

Me tej, ne skarpaten e jashteme dhe te brendshme, eshte parashikuar ndertimi i nje filtri me çakell te fraksionuar ne forme qilimi nen kundrabankinen prej guri i cili do te ndikojte ndjeshem ne qendrueshmerine e diges.

Perpos projektimit te elementeve te mesiperm nje rendesi te vecante i eshte dhene edhe pastrimit te kanaleve vadites.



Prerje tip e mbrojtjes L=134 m

2.1 ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Per ndertimin e objektit “Punime per Ndertimin,Riparimin ,Rritjen e Sigurise se Diges dhe Pastrimin e Kanalit te Shkarkimit (vaditese)”, projekti parashikon te perdoren materiale te cilesise se larte sipas standarteve te vendit dhe atyre nderkombetare.Te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve.

Gjate ndertimit te ketij objekti te kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Germimi ne trupin e diges dhe kanalit te shkarkimit eshte parashikuar me mjete
- 2.-Germimi per kanalet vadites eshte parashikuar me krah per shkak te tokave bujqesore te mbjella
- 3.- Mbushja e trupit te diges do te realizohet me shtresa cdo 20 cm + ngjeshje
- 4.-Mbushja me gure ne biefin e siperm/poshtem (bankina) do te realizohet sipas specifikimeve dhe detajit teknik ne projekt.
- 5.Sistemi i drenazhit do te realizohet sipas sipas specifikimeve dhe detajit teknik ne projekt.

2.2 KONKLuzionET

Gjate projektimit jane marre parasysh te gjithe faktoret e nevojshem per te siguruar qe projekti ne fjale te jete funksional, efikas dhe i thjeshte ne ndertim. Ne dimensionim jane marre ne konsiderate gjendja ekzistuese e diges, relievi dhe perspektiva e zhvillimit te zones.

SHOQERIA “HYDRO-ENG CONSULTING”Sh.p.k
Drejtues Ligjor
Inxh.Evis QYRKU